



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.51, datë 16/09/2005

**PËR  
“NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E SEKTORIT TË STREHIMIT PRANË  
DREJTORISË SË SHËRBIMEVE NJERËZORE NË BASHKINË E  
TIRANËS”**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31/07/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 32, (gërma ç), ligjit Nr.8549, dt.11/11/1999 “Statusi i Nëpunësit Civil”, Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë, ligjit Nr.9131, dt.08/09/2003 “Për rregullat e etikës në Administratën Publike”, ligjit Nr.9232, dt.13/05/2005 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, neni 35, pas shqyrtimit të relacionit të paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I;**

1. Të miratojë ngritjen dhe funksionimin e Sektorit të Strehimit në Drejtorinë e Shërbimeve Njerëzore, në Bashkinë e Tiranës, sipas tabelës bashkëlidhur.
2. Ndryshimin e emërimit dhe numrit të punonjësve të Sektorit të Shërbimeve Sociale dhe Strehimit (1+6) në Sektori i Shërbimeve Sociale (1+5).
3. Pika 2 e vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.18, datë 23/05/2005, ndryshon si vijon;  
  
“Numri i punonjësve të Aparatit të Bashkisë së Tiranës është;  
- Punonjës funksionar dhe nëpunës civil 349  
- Punonjës me kontratë 70
4. Efektet financiare të këtij Vendimi fillojnë më datë 01/10/2005 dhe do të mbulohen nga fondet e miratuara për paga dhe sigurime për Aparatin e Bashkisë, në Buxhetin e vitit 2005.
5. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve dhe Burimeve Njerëzore dhe Drejtoria e Përgjithshme Ekonomike për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**K R Y E T A R I**

**LUAN SHAHOLLARI**